



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Bulevardi "Zogu I", Godina 57/2, Nr.18 Tiranë,

Tel/Fax 04 2226814; 22268142

Nr. 589/7 Prot.

Tiranë më 06.02.2017

V E N D I M

Nr. 10, datë 06.02.2017

Mbi përfundimin e hetimit administrativ, filluar me Urdhërin nr. 589/1 prot., datë 30.09.2016, për verifikimin e ligjshmërisë së transferimit të nëpunësit ***.**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, neneve 77 e vijues të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", si dhe të Rregullores "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit nr. 14 prot., datë 13.01.2017, dhe mendimit të Drejtorisë së Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, lidhur me ligjshmërinë e veprimit administrativ të kryer nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, për transferimin e përkohshëm në detyrë të nëpunësit *****.

V ë r e j s e :

Nga përmbajtja e dokumentacionit të administruar në kuadër të hetimit administrativ, të filluar me urdhërin e verifikimit nr. 589/1 prot., datë 30.09.2016, "Për verifikimin e informacionit të ardhur nga punonjësi *****", në lidhje me transferimin e përkohshëm në detyrë", rezulton se, shkak për fillimin e kësaj procedure është bërë një ankesë e paraqitur prej nëpunësit ***** , protokolluar pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me nr. 589 prot., datë 23.09.2016, me të cilin ngrihet pretendimi se transferimi nga detyra e mëparshme "Specialist në Sektorin e Njesisë së Prokurimit" në pozicionin e "Kryetarit të Degës Doganore Korçë", është bërë në kundërshtim me rregullat e përcaktuara në nenin 50 të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar.

Duke shqyrtuar këtë dokumentacion, konstatohet se nëpunësi ******, nëpërmjet aktit nr. 3304/393 prot., datë 30.10.2014, është deklaruar “nëpunës civil”, në pozicionin e punës “Specialist në Sektorin e Njësisë së Prokurimit”, në Drejtorinë e Burimeve Mbështetëse, në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave. Për këtë nëpunës, nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, janë urdhëruar tre transferime të përkohshme, në pozicione të ndryshme të punës, të cilat janë realizuar gjatë intervalit kohor, 11.11.2014 deri në 23.03.2016, dhe transferimi i fundit në pozicionin e “Kryetarit të Degës Doganore Korçë”, është akoma në fuqi.

Shkaku i kësaj mosmarrëveshje që është bërë objekt i hetimit administrativ, është fakti që Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, me pretendimin e kryerjes së një riorganizimi më efikas dhe të përshtatshëm të punës, ka urdhëruar disa transferime të përkohshme, të njëpasnjëshme dhe në tejkalim të afateve kohore ky nëpunës nuk është kthyer në pozicionin e tij të punës.

Në referencë të neneve 87 dhe 88 të ligjit Nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, gjatë inspektimit, u informua personi i ngarkuar nga institucioni, për të drejtën që i rezervon ligji për t’u dëgjuar përpara se të merret vendimi përfundimtar nga Komisioneri, lidhur me çështjen në hetim.

Sipas pretendimeve të institucionit, ky transferim është bërë për të rritur eficientësinë në punë, bazuar në nenet 13/3 dhe 15/7, të ligjit nr. 102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, dispozita të cilat ndër të tjera, përcaktojnë se transferimi lejohet të bëhet në një nga departamentet e D.P.Doganave, në degë Doganore apo pranë strukturave të tjera ku atashohen, sipas ligjit, punonjës doganorë. Drejtori i Burimeve Njerëzore, sqaroi verbalisht se është në dijeni të kapërcimit të afatit të transferimit të përkohshëm dhe nga ana e institucionit po shikohet mundësia e rikthimit të kërkuesit në pozicionin e tij të punës.

Gjatë zhvillimit të këtij hetimi administrativ, institucioni, përmes Urdhrit nr 26824 prot., datë 16.11.2016 “ Për rikthim në detyrën e mëparshme ”, ka rikthyer nëpunësin ***** në pozicionin e mëparshëm të punës. Nga ana tjetër, vetë nëpunësi, ka njoftuar se nuk ka më pretendime lidhur me çështjen e ngritur prej tij pasi marrëdhënia e punës aktualisht vijon në përputhje me ligjin.

Nga gjithë sa u parashtrua më sipër, arrihet në përfundimin se gjendja e ligjshmërisë është rivendosur, e në këto kushte nuk është e nevojshme ndërhyrja apo investimi i mëtejshëm i Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

P e r k e t e a r s y e :

Bazuar në nenet 11/1, 14, dhe 15 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, nenit 90/2 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” dhe 34, të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

VENDOSA:

1. Përfundimin e hetimit administrativ, të nisur me urdhërin e verifikimit nr. 589/1 prot., datë 30.09.2016, *“Për verifikimin e informacionit të ardhur nga punonjësi *****”, në lidhje me transferimin e përkohshëm në detyrë*”, pasi nga ana e institucionit Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave janë kryer veprime administrative të cilat kanë rivendosur gjëndjen e ligjshmërisë.
 2. Të njoftohen për këtë vendim, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Departamenti i Administratës Publike dhe kërkuesi *****.
1. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA